



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 38
Prishtinë, më 11 nëntor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 NËNTOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare. Më tej ai sqaroi se pas një konsulte shtesë që kanë pasur me kryetarët e grupeve parlamentare, janë pajtuar që pika nr. 13 e rendit të ditës - **Debat parlamentar sipas kërkesës së Këshillit organizativ “Drejtësi në rastin Kiçina”**, të hiqet nga rendi i ditës. Pastaj, ai kërkoi nga deputetët deklarimin me votim për heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës të mbledhjes së sotme plenare.

Deputetët me ngritje dore votuan propozimin e kryetarit.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi hoqi nga rendi i ditës pikën nr. 13 - **Debat parlamentar sipas kërkesës së Këshillit organizativ “Drejtësi në rastin Kiçina”**.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 21 dhe 27 tetor 2011,

4. Ratifikimi i Marrëveshjes për financim shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,
5. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregti me jashtë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010,
12. Shqyrtimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ahmet Isufi, Ramiz Lladrovci, Gëzim Kelmendi, Naser Osmani, Glauk Konjufca, Agim Kuleta, Zenun Pajaziti, Vjosa Osmani dhe Liburn Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas përfundimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryetari theksoi se nga mbledhja e mbajtur më 8 nëntor 2011, kanë mbetur pa u votuar rekomandimet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i LDK-së lidhur me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën. Ai ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar i LDK-së që t'i paraqesë rekomandimet e grupit.

Kryetari i Grupit Parlamentar i LDK-së, **Ismet Beqiri**, tha se rekomandimet e propozuara nga ky grup i kanë harmonizuar me grupet e tjera parlamentare. Ai i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratojnë rekomandimet e propozuara.

Kryetari hodhi në votim rekomandimet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	72,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi këto:

R E K O M A N D I M E lidhur me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën

1. Kuvendi vlerëson se duhet të intensifikohen reformat në të gjitha fushat e shoqërisë, sidomos në reformën zgjedhore, e cila do të mundësojë legjitimitetin e plotë të institucioneve të ardhshme të vendit, të sigurohet sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës në tërë territorin e vendit, të zbatohen reformat ekonomike të

cilat do të mundësojnë zhvillim të diversifikueshëm, punësim dhe qëndrueshmëri buxhetore, reformim të administratës publike dhe rritje të përgjegjësisë dhe efikasitetit të saj.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës të angazhohet për përgatitjen dhe miratimin e ligjeve të domosdoshme për të gjitha reformat politike, ekonomike dhe sociale, për monitorimin e vazhdueshëm dhe intensiv të punës dhe të veprimeve të Qeverisë.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të përgatisë programin veprues në bazë të gjeturave, fakteve dhe analizave nga Raporti i Progresit. Me këtë program Qeveria duhet të marrë përgjegjësi të afatizuara për të siguruar sundimin e ligjit, eliminimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, politikën nxitëse për zhvillimin e sektorit privat, për rritje ekonomike dhe punësim, qeverisje të përgjegjshme kooperative të kompanive publike, reformim të prokurimit, kontroll të shpenzimeve publike dhe qëndrueshmëri afatgjate buxhetore, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare. Pra, duhet të sigurojë mos ndikimin politik në institucionet e pavarura, media dhe administratë, të sigurojë një sinergji të Kuvendit dhe komisioneve të tij, të Qeverisë dhe ministrive përkatëse, komunave dhe shoqërisë civile për bashkërenditje të veprimeve për plotësimin e të gjitha kritereve dhe kërkesave në fushën politike, ekonomike dhe sociale, të cilat bashkësia ndërkombëtare i shtron para Kosovës për integrimin evropian dhe euroatlantik.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës do të trajtojë në çdo tremujor progresin, plotësimin e kërkesave nga Raporti i Progresit dhe ta adresojë përgjegjësinë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Aurora Bakalli, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me vendimin për shfrytëzimin e hapësirave të parkingut në QKUK nga punëtorët e kësaj qendre. Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputeti Sali Morina, parashtroi pyetje për ministrin Bedri Hamza lidhur me atë se sa mirren parasysh deklaratat financiare për miratimin e ligjeve nga ana e Qeverisë, përkatësisht Ministrisë që ai drejton. Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetit Sali Morina.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 21 dhe 27 tetor 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të datës 21 dhe 27 tetor 2011.

4. Ratifikimi i Marrëveshjes për financim shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

Kryetari tha se, me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që ta ratifikojë Marrëveshjes për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Ai në vazhdim ftoi ministrin e Financave për prezantimin dhe arsyetimin e kësaj marrëveshje.

Ministri **Bedri Hamza**, në fillim të fjalës së tij tha se pas negociatave të zhvilluara me Bankën Botërore, kemi nënshkruar Marrëveshjen për financim shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, e cila arrin në vlerën mbi 40 milionë €.

Më tej, ai u fokusua në kushtet e kësaj marrëveshje që kanë të bëjnë me afatin e pagesave, kohën e maturimit të kredisë, afatet për zbatimin e saj etj.

Zbatuese e këtij projekti është Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tha ministri.

Në fund ai ftoi deputetët për ratifikimin e kësaj marrëveshje.

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se komisioni që ajo kryeson, ka shqyrtuar Marrëveshjen për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe ia kemi rekomanduar Kuvendin për miratim.

Në fund deputetja stafete Hadergjonaj, ftoi deputetët për miratim të kësaj marrëveshje.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, **kryetari** në vazhdim hodhi në votim Marrëveshjen për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	84,
Kundër-----	0,
Abstënime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

5. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

Kryetari tha se, me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që ta ratifikojë Marrëveshjes për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Ai në vazhdim ftoi ministrin e Financave për prezantimin dhe arsyetimin e kësaj marrëveshje.

Ministri **Bedri Hamza** tha se Marrëveshja për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, ofron një mundësi të mirë për përmirësimin e kushteve në lëmin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, e cila arrin në vlerën mbi 14 milionë €.

Më tej, ai u fokusua në kushtet e kësaj marrëveshje, ndërsa në lidhje me vlerën e nënprojekteve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, theksoi se ato kapin shumën nga 30 mijë € deri në 200 mijë €.

Në fund ai ftoi deputetët për ratifikim të kësaj marrëveshje.

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se komisioni që ajo kryeson ka shqyrtuar Marrëveshjen për financimin e projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe kemi rekomanduar Kuvendin për miratim.

Në fund deputetja Safete Hadergjonaj ftoi deputetët për miratim të kësaj marrëveshje.

Pasi nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, **kryetari** në vazhdim hodhi në votim Marrëveshjen për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	84,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financimin e projektit për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Ministrja **Mimoza Kusari -Lila**, tha se arsyet e nxjerrjes së këtij projektligji qëndrojnë në harmonizimin e tij me legjislacionin e vendeve të rajonit dhe me direktivën e BE-së, 2001/95/EC.

Në vazhdim, tha se ky projektligj rregullon kërkesat për sigurinë e përgjithshme të produkteve, detyrimet e prodhuesve dhe distributorëve, nxitjen e masave vullnetare, vendosjen në treg vetëm të produkteve të sigurta, si dhe përmbushjes së kërkesave të përcaktuara të parapara në projektligj.

Ajo më tutje foli për strukturën e këtij projektligji si dhe për përmbajtjen e kapitujve të këtij projektligji.

Në fund ajo kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes” Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiç, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vijim kryetari konstatoi se në sallë janë prezent 55 deputetë dhe për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të vazhdohet me procedurën e votimit.

Ai konstatoi të mbyllur punimet nga mbledhja e sotme, ndërsa vazhdimi i saj, tha se do të bëhet me dt. 14 nëntor 2011, në ora 10:00.

E hënë, 14 nëntor 2011

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar me datë 11 nëntor 2011. Ai tha se në radhë është pika nr. 6 e rendit të ditës - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.**

Kryetari, konstatoi se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur me dt. 11 nëntor 2011, ndërsa tani vazhdohet me procedurën e votimit për këtë Projektligj.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për hekurudhat e Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti.

Pasi që nuk pati deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64 dhe amendamentin nr. 65.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 42.

Pastaj, kryetar hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	76,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për hekurudhat e Kosovës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregti me jashtë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për tregti me jashtë. Raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti.

Pasi që nuk pati deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, dhe amendamentin nr. 42.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për tregti me jashtë.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme e arsyetoi zv.kryetari i këtij komisioni, deputeti Hydajet Hyseni.

Pasi që nuk pati deputetët tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, dhe amendamentin nr. 16.

Pastaj kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	57,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Deputetja **Rita Hajzeraj-Beqaj**, në emër të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Kuvendit i kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ajo u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur komisioni funksional.

Në fund ajo kërkoi miratimin e këtij raporti, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Kurtan Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kymete Bajraktari, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, bashkë me rekomandimet e Komisionit funksional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	65,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti dhe rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010

Në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputeti **Ali Sadriu**, tha se ky komision ka shqyrtuar Raportin vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Në vazhdim ai u fokusua në aspekte të veçanta të këtij raporti, duke vënë theksin në mos përmbushjen e rekomandimeve të komisioneve parlamentare, nga ana e institucioneve përkatëse.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Lutfi Haziri, Valbona Dibra, Alma Lama, Salih Morina, Salihe Mustafa, Armend Zemaj, Halit Krasniqi, Ali Sadriu dhe Ramiz Lladrovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti vjetor i auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

12. Shqyrtimi i Propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja, **Safete Hadergjonaj**, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin e bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%, dhe Kuvendit i kemi rekomanduar miratimin e këtij propozimi.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e propozimit të Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, **kryesuesi** hodhi në votim e Propozimin e bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet propozimi i Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale